

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Dragashi – Raporti komunal

Tetor 2009

## Dragashi në shifra

<b>Popullsia</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>35639</b>
	Shqiptarë	64%
	Goran	33.5%
	Të tjerë	0.5%
<b>Gjeografia</b>	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	435
	Numri i fshatrave	36
<b>Shkollimi</b>	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	18.29%
	Filllore/e mesme e papërfunduar	49.91%
	E mesme	24.69%
	Shkollë e lartë	5.68%
	Universitet	1.42%
	Nr. i nxënësve	6297
	Nr. i mësimdhënësve	402
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	1
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	65
	Nr. i çerdheve	0
	<b>Shëndetësia</b>	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		12
Nr. i mjekëve		21
<b>Papunësia</b>	Gjithsej	56.85%
	Meshkuj	49.81%
	Femra	81.58%
<b>Të punësuar</b>	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	21,740
	Të punësuar në sektorin publik komunal	704
<b>Buxheti 2009</b>	Gjithsej (Euro)	3,725,280
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	270,000
	Të hyrat tjera (Euro)	3,455,280
<b>Shpenzimet e realizuara (2008)<sup>1</sup></b>	Gjithsej (Euro)	2,685,459 (87%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	360,621 (63%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	2,324,838 (92.7%)
<b>Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007</b>	PDK	34.40%
	LDK	26.72%
	VAKAT	12.15%
	GIG	8.18%
	LDD	5.26%
	AKR	4.66%
	SDA	4.24%
	AAK	2.64%
	Tjera	1.75%
<b>Kryetarët e Komunës 1999-2009</b>	2000-2002: Halim Shemsedini (LDK) 2002-2007: Halim Shemsedini (LDK) 2007-2009: Salim Jenuzi (PDK)	

<sup>1</sup> Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

## Shkurt për Dragashin

Dragashi apo Sharri dallohet për tri karakteristika të veçanta që ka ky rajon: qentë e sharrit (apo pastori ilir), djathin e sharrit dhe është vendbanimi i evtëm ku janë të përqendruar komuniteti goran. Dragashi është komuna më jugore e Kosovës. Gjithashtu kjo komunë shtrihet në lartësinë më të madhe mbidetare në Kosovë, 1,500 metra lartësi mbidetare. Komuna e Dragashit ka një territor prej 435 km/2, që e rëndit atë në vendin e dhjetë për nga madhësia gjeografike në Kosovë. Komuna e Dragashit përbëhet nga dy treva etnike – treva e Opojës e banuar me shqiptarë (të shtrirë në 18 fshatra) dhe treva e Gorës e banuar me Boshnjakë-Goranë (poashtu e shtrirë në 18 fshatra), që në total përbëjnë 36 vendbanime. Dragashi vlerësohet të ketë afër 50,000 banorë (edhe pse sipas statistikave zyrtare popullsia e kësaj komune është rreth 35,000) ku dy të tretat janë shqiptar dhe një e treta janë Goran/Boshnjak. Komuna e Dragashit shquhet për tolerancë ndëretnike midis këtyre dy bashkësive. Për shkak të resurseve të varfra bujqësore dhe izolimit gjeografik, komuna e Dragashit është një nga rajonet më të pazhvilluara në Kosovë me një shkallë shumë të lartë të papunësisë. Është pikërisht papunësia që ka ndikuar në rritjen e madhe të migrimit të popullatës së kësaj komune.

## Problemet aktuale

Izolimi gjeografik i Dragashit si dhe largësia e madhe nga kryeqyteti, mund të konsiderohen ndër faktorët që kanë rezultuar në moszhvillimin e duhur të kësaj komune. Edhe pse papunësia është problem i përgjithshëm i Kosovës, në këtë komunë ky problem po manifestohet me shpërngulje të popullatës. Ndër problemet më aktuale të kësaj komune janë:

- Migrimi i popullatës
- Mos integrimi i nxënësve goran në planprogramet mësimore të Kosovës
- Mos subvencionimi i bujqësisë
- Mungesa e ujit të pijshëm
- Mungesa e transportit me Prizrenin

Mos zhvillimi ekonomik i kësaj komune ka rezultuar në **migrimin e vazhdueshëm të popullatës**. Edhe pse qytetarët e komunës së Dragashit njihen për familje të shumta që jetojnë jashtë vendit, pas luftës migrimi i individëve dhe në shumë raste edhe i familjeve të tëra është shpeshtuar. Kjo dukuri është edhe më serioze në mesin e komunitetit goran të kësaj komune. Sa për ilustrim po përmendim faktin se vetëm nga fshati Lubovisht janë shpërngul 10 familje kohët e fundit. Një gjë e tillë ka ndodh edhe me disa familje nga fshati Krushë si dhe nga fshati Vranisht. Megjithatë, mërgata mbetet njëri nga burimet e vetme financiare për shume familje të Dragashit. Thuhet se 40 për qind e popullatës jetojnë nga të afërmit e tyre që gjenden me punë jashtë vendit. Por kjo nuk justifikon trendin në rritje të migrimit, i cili vjen si pasojë e mungesës së politikave për parandalimin e migrimit. Një problem tjetër i lidhur me migrimin është edhe projekti i paraparë për ndërtimin e Hidrocentralit Zhuri, i cili parasheh zhvendosjen e disa shtëpive të fshatit Çellopek dhe një pjese të fshatit Brezne. Qytetarët e këtyre fshatrave deri më tani nuk kanë marrë ndonjë informatë se ku do të zhvendosën, si do të bëhet kompensimi i pronave të tyre, etj.

Një nga problemet më serioze me të cilat ballafaqohet një pjesë e madhe e komunitetit goran është **mosintegrimi i nxënësve goran në planprogramet shkollore të Kosovës**. Në disa shkolla të komunës së Dragashit, në pjesën e Gorës, akoma punohet me planprograme të shkollave të Serbisë. Planprogramet serbe aplikohen si në shkollat fillore ashtu edhe në ato të mesme. Nxënësit goran që më parë mësonin në gjimnazin e vetëm në komunë 'Fetah Sylejmani' (ish 'Nazim Berati') që gjendet në qytetin e Dragashit, tashmë janë larguar nga aty dhe mësojnë në gjimnazin e fshatit Mlik, ku aplikohet planprogrami serb. Aty dhe në të gjithë shkollat fillore në fshatrat Restelicë, Brod, Gllaboçic, Rapç etj, mësuesit paguhen nga buxheti i Serbisë. Rroga e mësuesve, e cila sillet prej 650 euro deri në 1050 euro (për ata me fakultet) në muaj, është mjaft stimuluese, prandaj edhe nuk është treguar ndonjë vullnet nga këto shkolla që të ndërpresin bashkëpunimin me ministrinë e arsimit të Serbisë dhe të aplikojnë planprogramin e shkollave të Kosovës. Edhe për kundër iniciativave të komunës, ata nuk janë pajtuar që të heqin dorë nga planprogramet e Serbisë. Përrjashtim bën iniciativa e fshatit Restelicë që ka afër 500 nxënës për futjen e planprogramit të Kosovës në shkollën e tyre, por siç thuhet, një iniciativë e tillë ka has në neglizhencë të komunës.

**Mos subvencionimi i bujqësisë.** Toka e komunës së Dragashit është shumë e përshtatshme për kultivimin e disa perimeve, në veçanti patates. Edhe pse zhvillimi i bujqësisë duhej të ishte prioritet i secilit pushtet lokal në këtë komunë, nuk është vërejtur ndonjë strategji zhvillimore deri më tani. Përveç iniciativave individuale, komuna nuk ka ndonjë plan si të zhvilloj bujqësinë dhe të shfrytëzoj tokat kolektive, si atë të Mejdanit, ku më parë është kultivuar gruri apo patatja. Kjo është një hapësirë e madhe prej 300 hektarësh që tash e sa vjet nuk shfrytëzohet. Vlen të cekët gjithashtu se territori i Dragashit është mjaft i përshtatshëm për rritjen e disa bimëve të rralla, siç është boronica. Vjelja e këtyre bimëve çdo vit bëhet nga kompani private të cilat stimulojnë qytetarët e kësaj komune të bëjnë vjeljen e tyre dhe ia shesin më pas këtyre kompanive. Kësisoj komuna nuk përfiton asgjë. Një praktikë e tillë i kushton komunës 200,000 deri 300,000 euro në vit humbje.

Mungesa e **ujit** të pijshëm është preokupim i një pjese të qytetit të Dragashit. Uji bashkë me kanalizimin konsiderohen si dy probleme që kërkojnë zgjidhje sidomos në qytetin e Dragashit. Mungesa e ujit në qytetin e Dragashit thuhet se kërkon investime të mëdha. Megjithëse në territorin e Dragashit besohet se ekzistojnë burime të ujit, uji duhet të sillet nga distanca të largëta. Banorët përmendin burime nga fshati i Restelicës, një projekt ky që velrësohet se kushton rreth 2-3 milion euro. Kanalizimi është problem për disa fshatra të Dragashit, si fshati Kosavë, Kuk dhe Kuklibeg që nuk kanë infrastrukturë të kanalizimit. Nuk është e çartë nëse kandidatët për kryetar komune kanë ndonjë plan për zgjidhjen e problemit të ujit në qytetin e Dragashit si dhe ndërtimin e kanalizimeve për fshatin Kosavë, Kuk dhe Kuklibeg.

Pasi që Dragashi është komuna më jugore e Kosovës, si qendër më të afërt zhvillimore kjo komunë ka qytetin e Prizrenit. Por, mungesa e shpeshtë e transportit me Prizren pamundëson lëvizjen e shpeshtë të qytetarëve të Dragashit dhe banorëve të Gorës. Qyteti i Dragashit është 37 kilometra larg Prizrenit, por transporti publik – autobusët që lidhin këtë relacion janë shumë të rrallë. Përveç transportit privat, qytetarëve iu duhet të presin me orë të tëra për autobusin e radhës për në Prizren. Në anën tjetër qytetarët e Dragashit dhe rrethit të Gorës shpesh detyrohen të udhëtojnë prej Prizrenit deri në vendin e quajtur Tyrbe, me autobusë që shkojnë për në fshatrat

e Opojës e që janë më të shpeshtë se sa autobusët që shkojnë për Dragash. Nga Tyrbeja ata detyrohen të paguajnë kombi taksitë deri në Dragash. Mungesa e transportit është e dukshme edhe në vetë komunën, sidomos transporti për bartjen e nxënësve shkollor. Vlen të cekët rasti i nxënësve të shkollës fillore që udhëtojnë nga fshati Buzes në fshatin Bresanë nëpër magjistralen që lidh këto dy fshatra e cila frekuentohet shumë nga automjetet. Pastaj nxënësit e fshatit Pllajnik detyrohen të udhëtojnë në fshatin Kosavë edhe në kushte të vështira të dimrit. Rrezikut të komunikacionit i nënshtrohen edhe nxënësit që udhëtojnë nga fshatrat Rrencë-Pllavë-Llapushnik. Mungesa e transportit jo vetëm që rrezikon jetën e këtyre filloristëve por bën që disa nga ta të braktisin shkollën shumë më herët.

## Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në zgjedhjet lokale të vitit 2007, për herë të parë në këtë komunë qeverisja iu besua PDK-së. Kryetar komune u zgjodh Salim Jonuzi, pas raundit të dytë zgjedhjeve. Në zgjedhjet e balotazhit të dhjetorit 2007 përfundimisht kandidati i PDK-së, Salim Jonuzi doli fitues ndaj Shemsedin Halimit, kryetarit të deriatëhershëm të komunës për dy mandatet e kaluara. Në raundin e parë të zgjedhjeve Salim Jonuzi fitoi 4.765 vota apo 40.5%, kurse në raundin e dytë fitoi 5.591 vota apo 54.8%.

Ndonëse Salim Jonuzi nuk kishte dhënë edhe aq shumë premtime në fushatën parazgjedhore, ai ka arritur që brenda mandatit të tij dy vjeçar t'i realizoj vetëm pjesërisht edhe ato pak premtime që kishte dhënë. Premtimi i tij se do të zgjidh problemet ekonomike të qytetarëve të kësaj komune, nuk është përmbushur, pasi se ky është një problem kombëtar dhe si i tillë është përtej kapaciteteve të tij. Kryetari Jonuzi ka qenë i suksesshëm në rritjen e grantit qeveritar për komunën e Dragashit, grant ky që deri para tij ishte marrë për 35,000 banorë përderisa komuna besohet të ketë rreth 50,000 banorë, premtim ky i realizuar nga Jonuzi. Një nga premtimet e pa realizuara të tij mbetet mos integrimi i nxënësve goran në planprogramet shkollore të Kosovës. Ishte premtuar se një pjesë e nxënësve goran që mësojnë me planprogramet e Serbisë do t'i integroj në sistemin shkollor kosovar dhe se mësuesit e tyre që marrin rroga të majme nga Qeveria e Serbisë do të inkuadrohen në sistemin edukativ të Kosovës.

Për dallim nga qeverisja e kaluar, kjo qeverisje është dalluar të jetë më transparente kundrejt qytetarëve, të ulë koston e shpenzimeve të pa nevojshme publike, si dhe të punësojë njerëz të kualifikuar e jo partiak, me përjashtim të drejtorëve të shkollave ku avazi i emërimeve partiake ka vazhduar.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Se do të mundohet që të zgjidh problemet ekonomike të qytetarëve të Komunës së Dragashit, duke u përqendruar në krijimin e mundësive për shkollim të fëmijëve dhe në përmirësimin e gjendjes në shëndetësi;	Premtim i realizuar vetëm pjesërisht. Problemet ekonomike vazhdojnë. Me përjashtim të rreth 300 punëtorëve të punësuar në fabrikën e REMATEX-it, nuk është bërë më tepër. Në shëndetësi është investuar pjesërisht; QKMF është zgjeruar sikurse edhe QMF në Bresanë.
Do të rris bashkëpunimin me qytetarë dhe se Asambleja Komonale do të vendos ashtu siç vendosin edhe vetë qytetarët apo një grup	Premtimi nuk është realizuar.

fshatrash	
Se do të angazhohet që të rritet granti qeveritar për komunën e Dragashit	Premtimi është realizuar. Tani komuna konsiderohet të ketë rreth 50,000 banorë, prandaj edhe granti është rritur. Granti i përgjithshëm që ka qenë 659,990 euro në 2008, është bërë 1,722,163 euro në 2009; granti i arsimit nga 1,336,979 euro në 2008, është bërë 1,373,254 euro në 2009; kurse granti për shëndetësi nga 281,753 euro që ka qenë në 2008, është rritur në 359,863 euro në 2009.
Se në administratë dhe arsim do të punësoj njerëz profesionistë, e jo njerëz partiak dhe jo profesionistë	Premtim deri diku i realizuar. Njerëz profesionist nuk janë shkarkuar për shkak të partisë, përveç në ndërrimin e drejtorëve të shkollave, ku është përsëritur praktika e qeverive të kaluara.
Se me zgjidhjen e tij dhe të PDK nxënësit goran nuk do të mësojnë më me plan-programe mësimore serbe, por me ato shqiptare dhe se nxënësit serb do të integrohen në strukturat legale komunale.	Premtim i pa realizuar. Edhe përkundër vullnetit komunal për të integruar atë pjesë të nxënësve goran, një gjë e tillë akoma nuk është realizuar.
Se do të ju ofrojë infrastrukturë këtyre tri pikave turistike: Zaplugjës, Brodit dhe Liqenit të Breznës.	Premtim i pa realizuar. Përveç Brodit, që ka pas investime nga njerëz privat, asgjë tjetër nuk është bërë.

## Zgjedhjet lokale në Dragash

Në zgjedhjet e para lokale të mbajtura në vitin 2000, LDK-ja dukshëm kishte fituar ndaj partisë rivale në këtë komunë, asaj të PDK-së. Nga 21 ulëse në KK, LDK-ja kishte siguruar 10, kurse partia në opozitë, PDK-ja vetëm 6. Kryetar i komunës ishte zgjedhur Halim Shemsedini. Halim Shemsedini iu besua edhe një mandat tjetër, kur LDK-ja përsëri fitoi zgjedhjet e vitit 2002. Por, kësaj radhe LDK kishte dy ulëse më pak se në mandatin e kaluar, vetëm 8 sosh, përderisa PDK kishte numri e njëjtë të ulëseve, 6. Zgjedhjet e vitit 2007 sollën një skenar tjetër. Pas balotazhit, zgjedhjet i fitoi PDK-ja dhe për herë të parë qeverisja lokale iu besua këtij subjekti politik me në krye Salim Jonuzin. Numri i 21 ulëseve në KK u nda mes 8 partive; PDK me 7 ulëse, LDK me 5 ulëse, përderisa befasuese ishte fitorja e partisë së komunitetit goran VAKAT e cila siguroi 3 ulëse. Tabela në vazhdim jep më shumë detaje rreth zgjedhjeve në tri mandatet e kaluara.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Dragashit.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	4324	6	3866	6	4159	7
LDK	6509	10	4884	8	3231	5
AAK	-	-	338	1	319	1
LDD	-	-	-	-	636	1
AKR	-	-	-	-	563	1
GIG	1789	3	1275	2	989	2
VAKAT	-	-	-	-	1469	3

SDA	1701	2	-	-	513	1
VATAN	-	-	1729	3	-	-
LPK	-	-	384	1	-	-

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale të vitit 2000 dalja e votuesve në zgjedhje ishte 15,310, apo 78.4%, në zgjedhjet e vitit 2002 numri i votuesve ra në 13,906 apo 47.6%. Në vitin 2007 pjesëmarrja në votime kishte shënuar rënie edhe më të madhe, ku nga 30,273 votues me të drejtë vote, vetëm 12,091 kishin dalë në zgjedhje, apo 39.9%. Numri i personave me të drejtë vote në zgjedhjet e ardhshme të Nëntorit 2009 do të jetë 35,360.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Dragash në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
<b>Votues me të drejtë vote</b>	<b>20166</b>	<b>29233</b>	<b>30273</b>	<b>35460</b>
<b>Pjesëmarrja në votime</b>	<b>15810</b>	<b>13906</b>	<b>12091</b>	<b>-</b>
<b>Përqindja e daljes në votime</b>	<b>78.4%</b>	<b>47.57%</b>	<b>39.9%</b>	<b>-</b>

## Buxheti i Komunës

Prej vitit 2003 deri në vitin 2008 buxheti i Komunës së Dragashit asnjëherë nuk ka qenë më i madh se 3 milion euro. Gjatë këtyre viteve komuna ka pas një buxhet që mesatarisht rreth 2.5 milion euro. Një faktor që ka ndikuar në mos rritjen e buxhetit të komunës mund të konsiderohet edhe marrja e granteve qeveritare për 35,000 banor, përderisa kjo komunë vlerësohet të ketë rreth 50,000 banorë. Rritja më e madhe e buxhetit ka ndodhë në vitin 2009, në 3,725,280 euro, që krahasuar me buxhetin e vitit 2008 është rritur për 1,035,681 euro. Pjesa më e madhe e buxhetit vjetor 2009 është shpenzuar për investime kapitale, gjithsej 1,137,247 euro, që është rreth 749,238 milion euro më shumë se në vitin paraprak.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
<b>2009</b>	€2,153,446	€303,087	€91,500	€40,000	€1,137,247	€3,725,280
<b>2008</b>	€1,837,827	€336,763	€88,500	€38,500	€388,009	€2,689,599
<b>2007</b>	€1,764,187	€343,268	€80,500	€14,000	€297,971	€2,499,926
<b>2006</b>	€1,763,187	€372,983	€74,480	€34,013	€383,069	€2,627,732
<b>2005</b>	€1,695,981	€369,761	€89,200	€4,998	€657,236	€2,817,176
<b>2004</b>	€1,621,309	€593,446	-	-	€465,810	€2,680,565
<b>2003</b>	€1,303,861	€743,642	-	-	€129,539	€2,178,366

Nga tabela e mësipërme mund të vërejmë se kryesisht ka pas një rritje konstante në shpenzimet për rroga dhe mëditjet që nga viti 2003 e këtej. Një dallim i madh mes vitit 2008-2009 mund të vërtete edhe në shpenzimet për rroga dhe mëditje, ku gjatë



vitit 2009 nga buxheti total i komunës prej 3,725,280 euro, 2,153,446 euro janë shpenzuar për rroga dhe mëditje, që krahasuar me vitin 2008 për rroga dhe mëditje janë shpenzuar afër 315,619 euro më tepër.

## Investimet kapitale

Komuna e Dragashit për vitin 2008 nga buxheti i saj kishte ndarë 388,009 euro për investime kapitale. Këto mjete janë investuar në projektet e mëposhtme:

Tab.5.: Investimet kapitale në Dragash gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës Dragash-Resticë	€77,585
2008	Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Zgata	€42,208
2008	Asfaltimi i rrugës Dragash-Radesh	€123,396
2009	Ndërtimi i kanalizimit në Dragash	€30,000
2009	Ndërtimi i ambulancës në fshatin Bresan	€60,000
2009	Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Restelicë	€20,000

Në vitin 2009 nga buxheti i përgjithshëm, investimet kapitale janë rritur dukshëm në 1,137,247 euro, apo rreth 749, 238 euro shumë se në vitin 2008. Shpenzimet në investime kapitale në tri vitet e ardhshme janë paraparë të rriten edhe më tej. Kuvendi Komunal i Dragashit veç ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, Komuna e Dragashit do të ketë në dispozicion 4,678,369 euro për investime kapitale, gjegjësisht 1,505,961euro për 2010, 1,543,372 euro për 2011, dhe 1,629,036 për vitin 2012.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Dragashit 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	4,236,622	4,393,837	4,556,751
Të hyrat vetanake në €	356,891	368,221	378,843
Investimet kapitale në €	1,505,961	1,543,372	1,629,036

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Dragashit për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion rreth 6 milion euro për investime kapitale.

## Administrata komunale

Në komunën e Dragashit të dhënat për vitin 2009 tregojnë se numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë është 721. Krahasuar me vitin 2008, numri i shërbyesve civil është rritur për 21 persona. Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2008), e cila thotë se për 620 banorë duhet të ketë një punëtorë administrativ, del se komuna e Dragashit duhet të ketë 111 shërbyes civil, e jo 120 sa ka tani.



Komuna e Dragashit dallohet nga të gjithë komunat tjera të Kosovës me përqindjen shumë të ulët të gruas në stafin administrativ. Gjendja e pjesëmarrjes së gruas në këtë komunë paraqet vetëm 9.1% të stafit administrativ, duke renditur kështu Dragashin në vendin më të ulët sa i përket përfaqësimit të femrave. Sipas Ligjit për barazi gjinore, institucionet publike në përgjithësi duhet që të bëjnë përpjekje që me rastin e rekrutimeve për pozita në shërbimin civil, t'i japin mundësi të barabarta të dy gjinive, duke bërë përpjekje që të arrihet përfaqësimi i femrave në masën 40%. Sa i përket komunave, vetëm komuna e Obiliqit e ka arritur këtë objektiv, kurse në të gjitha komunat tjera femra është e nën përfaqësuar.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Dragashit sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	721 ▲
2008	705 ▲
2007	686
2006	718
2005	744 ▲
2004	737 ▲
2003	695 ■

Në komunën e Dragashit, sipas statistikave të Marsit 2009, krahasuar me vitin 2008 ka shënuar rritje të punëtorëve në arsim, prej 484 në 508, ka shënuar rënie në numrin e punëtorëve të shëndetësisë prej 103 në 98.

## Komuna e Dragashit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht numrin e mbledhjeve që duhet t'i mbaj kuvendi komunal gjatë një viti, Dragashi qëndron kryesisht mirë. Gjatë vitit 2008, KK ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje, as edhe sa është i obliguar të mbaj sipas ligjit. Në gjashtëmuorin e parë të 2009 janë mbajtur pesë mbledhje të legjislativit të kësaj komune. Ndërkaq, Komiteti për Politikë dhe Financa, është takuar gjithsej 7 herë më 2008 dhe 5 herë në periudhën janar-qershor 2009. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik të komunës.

Ndërsa sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarët, komuna e Dragashit gjatë vitit 2008 ka mbajtur 3 tubime publike, kurse në vitin 2009 është mbajtur një tubim publik. Qytetarët njoftohen për mbajtjen e tyre të paktën 10 ditë më herët, kryesisht përmes dy radiove lokale të kësaj komune. Megjithatë, pjesëmarrja e qytetarëve është tejet e vogël.

Gjatë vitit 2008 ka pasur vetëm një peticion drejtuar Kuvendit Komunal. Komuna ka miratuar 4 rregullore, kurse asnjë kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare nuk është regjistruar.

Komuna e Dragashit ka hapur faqen e saj të internetit në fillim të vitit 2009. Në pikëpamje të kategorive, informacioneve, dokumenteve, të dhënave dhe niveleve të informatave tjera që janë publikuar në këtë ueb faqe, rezulton që ueb faqja ka përmbajtje mesatare të të dhënave të publikuara. Veçanërisht, duhet përmendur që ueb faqja e KK Dragash nuk ka aspak informacione rreth shërbimeve komunale, nuk ka informacione në gjuhën serbe; si dhe ka informacione tejet të cekëta në lidhje legjislacionin.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Dragashit (<http://www.komuna-dragashi.org>)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave <sup>2</sup>
Ballina	3
Organizimi komunal	3
Shërbimet komunale	1
Info rreth qytetit	1.88
Projektet komunale	1.5
Lajme& lajmërim	4.67
Harta e faqes	1
Kontakt	3
Gjuhët	1
Fusha për kërkim	5
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	3
Mesatarja totale	2.5
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	20

## Gjendja në arsim

Komuna e Dragashit është ndër komunat e rralla në Kosovë që nuk ka çerdhe të fëmijëve, detyrë kjo që mbetet të plotësohet nga organet komunale pasi se numri i fëmijëve që kanë nevojë për çerdhe është në rritje e sipër. Edhe pse gati të gjithë fshatrat kanë shkollat e tyre, sistemi parashkollor zhvillohet vetëm në 11 shkolla. Kjo komunë ka 35 shkolla filllore, prej të cilave 23 janë degë të shkollave në fshatrat e largët për klasat 1-4, kurse 12 të tjera janë shkolla filllore amë. Gjashtë prej tyre janë në rajonin e Opojës dhe gjashtë në atë të Gorës, si dhe një në qytetin e Dragashit për nxënësit shqiptar dhe goran. Dragashi ka vetëm një shkollë të mesme 'Fetah Sylejmani', ku mësimet i ndjekin rreth 900 nxënës.

Numri i nxënësve në këtë komunë është 6297, kurse numri i mësuesve është 402, që ka një statistikë prej 1.4 punonjës të arsimit për 100 banorë. Megjithatë, kjo komunë përballet me një problem specifik. Një pjesë e nxënësve goran vazhdojnë që në shkollat e tyre të aplikojnë planprogramet e Serbisë. Madje ata kanë edhe gjimnazin në fshatin Mlik, në të cilin janë transferuar edhe shumë nxënës që më parë vijonin

<sup>2</sup> (rradhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

mësimet në shkollën 'Fetah Sylejmani'. Punonjësit arsimor që japin mësim në shkollat serbe paguhen nga buxheti i Serbisë, dhe kanë paga më të mëdha se kolegët e tyre shqiptar. Mos integrimi i nxënësve goran në planprogramin e Kosovës mbetet një problem serioz që duhet zgjidhur nga organet kompetente komunale në mandatin që po vjen.

## Gjendja në shëndetësi

Në Komunën e Dragashit funksionon Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, 5 Qendra të Mjekësisë Familjare dhe 7 ambulanca shëndetësore, në terren të të dy trevave - Opojës dhe Gorës. Numri i punëtorëve shëndetësor që u ofrojnë shërbime popullatës në territorin e Komunës është 103: specialistë, mjekë, teknikë dhe punëtorë ndihmës shëndetësorë, kurse vetëm mjekë janë 21. Sipas statistikave kjo komunë ka 2.9 punëtorë shëndetësor për 1000 banorë, dhe kjo komunë nuk qëndron edhe aq keq krahasuar me komunat tjera. Gjatë dy viteve të kaluar nuk janë bërë shumë investime në sektorin e shëndetësisë, përveç zgjerimit të QMF-së në fshatin Bresanë, dhe një gjysmërrethoje që është ndërtuar në QKMF në Dragash. Banorët e kësaj komune për raste më të rënda preferojnë të vizitojnë spitalin rajonal të Prizrenit se sa QKMF në Dragash.

## Shoqëria civile

Komuna e Dragashit kishte të regjistruara afër 32 OJQ, shumica e të cilave kanë pushuar aktivitetet e tyre. Në përgjithësi, shoqëria civile në Dragash është shumë pak aktive, si dhe një pjesë e vogël madje është edhe e politizuar. Mungesa e fondeve, injorimi i tyre nga komuna, kanë bërë që aktivitetet e tyre të jenë shumë të vogla. Një nga OJQ-të më me zë është Qendra e Rinisë në Dragash. Ndër OJQ-të tjera që deri vonë kanë shënuar ndonjë aktivitet janë edhe 'Mështekna', 'Melmeqët', 'Dora e Ndhmës', 'Flaka' etj. Megjithatë, aktivitetet e tyre janë tejet të pakta andaj një shoqëri e tillë civile nuk ka kapacitete për të monitoruar punën e pushtetit lokal.

## Mediat lokale

Komuna e Dragashit ka vetëm dy radio lokale, Radio Sharri dhe Radio Gora. Kjo e dyta emeton programe në gjuhën boshnjake. Radio Sharri vazhdimisht transmeton mbledhjet e Asamblesë Komunale në saje të pagesës që bëjnë këta të fundit. Të dy këto radio janë radio komerciale. Edhe gazetat ditore kanë korrespondentët e tyre në këtë komunë.

## Rendi dhe ligji në Komunën e Dragashit

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Dragashit kanë ndodhur **381** raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë **32 shkelje të natyrave të ndryshme**. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Dragash (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	45
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	38
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	12
Vjedhje e pyjeve	1
Incidente lidhur me pronën	41
Vjedhje	89
Abuzime seksuale	2
Shkaktim të dëmtimeve trupore	11
Kërcënime	42
Mashtrime	3
Vrasje	-
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	-

Në krahasim me komunat tjera, Komuna e Dragashit renditet pothuajse në fund të tabelës për nga numri rasteve të prishjes së rendit dhe qetësisë publike. Gjatë vitit 2008 ka pasur 38 raste të tilla, që e rëndit këtë komunë në vendin e 25 për nga numri i madh i prishjeve të rëndit. Po ashtu në këtë komunë nuk ka ndodhur asnjë incident në baza etnike, dhe kur dihet se kjo komunë është e banuar nga dy etni, kjo mund të konsiderohet si e arritur e kësaj komune.

## Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05% dhe 1% të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Dragashit

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	<b>Norma tatimore</b>				
	0.17%	0.17%	0.20%	0.20%	-
I	250€*	200€	500€	450€	-
II	200€	150€	400€	400€	-
III	-	-	-	-	-
IV	-	-	-	-	-

\* Vlera e tregut për metër katror.

## Kostoja për biznese

Në komunën e Dragashit aktualisht janë të regjistruar 627 biznese. Në bazë të rregullores së Komunës së Dragashit për taksa, ngarkesa dhe gjoba, komuna ka paraparë nivelin e pagesës për funksionimin e çdo lloji të biznesit në këtë komunë.

Më poshtë mund të shihni taksat vjetore për disa nga bizneset më të zakonshme në komunën e Dragashit:

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	300 €
Kompanitë e sigurimit	300 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	300 €
Agjensionet turistike	250 €
Hotelet	250 €
Motelet	250 €
Supermarketet-Hipermarketet	250 €
Vetëshërbimet – Minimarketet	250 €
Kafeteritë	50-150 €
Restorant	150 -250 €
Industria e mishit dhe prodhimet bujqësore	400 €
Libraritë	50- 70 €
Kioskat	50- 70 €
Barnatoret (Farmacitë)	250 €
Autoshkollat	250 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, frizerët, etj.)	50 €
Ndërmarrjet (ndërtimore, industriale, etj.)	300 – 400 €
Pompat e benzinës	300 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	75 – 150 €

## Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, [www.jetanekosove.com](http://www.jetanekosove.com).
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.